

**RAPORT NGA KAMPI VEROR PËR FËMIJË ULQINI 2006**  
**NGA DATA 25/08-06/09/2006**

Mbështetur dhe financuar nga **ONLUS R.BAZONI**  
Financuar nga **HANDIKOS**

**Pjesmarrës** – 48 persona (22 fëmijë, 22 përcjellës si dhe 4 punëtorë nga Handikosi (ekipi implemetues))

**Gjinia:** 09 / vajza  
13 / djem

**Përcjellësit:** 21 nëna  
01 gjyshe  
01 teze

**Diagnozat:** 06 fëmijë me Paralizë Cerebrale  
04 fëmijë me Hemiparezë  
04 fëmijë me Sy Down  
02 fëmijë me RPM  
02 fëmijë me LCC  
01 fëmijë me Hypophrenia  
01 fëmijë me Spina Bifida  
01 fëmijë me Kyphoscoliosis  
01 fëmijë me Paralysis Brahialis

**Ekipi nga HDK:**

Vera Pitaqi – Mjeke si dhe përgjegjëse e kampit  
Hatixhe Salihu – Kordinatore e aktiviteteve  
Lumnije Muzaqi – Ass e aktivitetit psiko-sociales  
Shukrije Vokshi – Ass e aktivitetit të fizioterapis

**Operime :** 07 fëmijë me operime të ndryshme

**Transporti:** Është bërë nga agjencioni turistik Shpejtimi Tours ( me autobus)

**Udhëtimi** – Nisja nga Prishtina është bërë në ora 20:30 me datën 25/08/06 arritja në Ulqin në ora 07:00 me datën 26/08/06 ndërsa kthimi është bërë me datën 05/09/06 kurse arritja në Prishtinë me datën 06/09/06 në ora 06/30.

**Ceremonia e Hapjes** – Në mbremjen e parë është bërë ceremonia e hapjes me ç’rast është prezentuar historiku mbi krijimin e OJQ BAZZONI ( donator I deritanishëm I kampeve ) e cila është e lidhur ngusht me emrin e personit I cili është sakrifikuar për ti ndihmar personat me aftësi të kufizuar në Kosovë, orarin e aktiviteteve (e që është vendosur edhe në qdo dhomë)është bërë shpërndarja e dhuratave përmbajta e të cilave ka qenë materiali për aktivitetet e psikosociales, maica me llogo të HandiKOS-it, OJQ - R.Bazzoni-t dhe në to ka qenë I shtypur emri dokoreshës Julia Palao, si dhe lodrat së bashku me maskat e po ashtu ne këtë mbremje është bërë edhe shpërndarja e të hollave pasi që disa nga pjesmarrësit nuk kanë pasur as një metelik si shkak I kushteve të rënda ekonomike.



**Aktivitetet e mëngjesit** – Në aktivitetet e mëngjesit fëmijët kanë qenë të ndarë në dy grupe ku njëri grup ka mbajtur aktivitetet e fizios kurse tjetri aktivitetet e psiko-sociales dhe anasjelltas.

**Aktivitetet Psiko-Sociale**-gjatë këtyre dhjetë ditve është bërë punë didaktike(laps gërhshërë, ngjyra etj),puna me rërë(vizatime me rërë),demonstrimi,aplikimi i metodes për punë grupore si dhe metoda e bashkëbisedimit në mes fëmijve.

**Aktivitetet e Fizioterapis** – Kryesisht është punuar fizioterapi active si dhe active të ndihmuara, është demonstruar higjiena personale nga fëmijët si dhe autonomia personale, mirpo nuk kanë munguar edhe këshilla të ndryshme.

Statistika e fëmijve pjesmarrës në aktivitetet e mëngjesit:

Data	26	27	28	29	30	31	01	02	03	04	05
Fizio	0	11	11	11	11	11	10	11	10	11	10
psiko	0	11	11	11	11	10	11	10	11	10	0

**Plazhi** – Është mbajtur nga ora 10:00-12:45 para dite kurse pas dite nga ora 15:00-18:00 mirpo shumica nga pjesmarrësit edhe kohën e pas drekës kohën për pushim e kanë shfrytzuar për plazhë. Ku gjatë kësaj kohe janë zhvilluar edhe aktivitete të ndryshme si loja me rërë, noti, loja me litar, hokey, parashut, me thasë zalli etj, gjithashtu përveq aktiviteteve që kanë qenë në orar janë mbajtur edhe lojra tjera të ndryshme si loja e tenisit, vallzimi në ujë etj.Gjatë kohës së plazhit një ditë kemi vizituar edhe plazhën e madhe, udhëtimi është bërë me anije dhe na është ofruar falas nga pronari..Për shkak të kohës jo të mir dy ditë nuk kemi dalur në Plazhë ( me datën 28 dhe 29) e që për këtë shkak edhe është shtyr shetitja me anije për datën 31mirpo gjatë qëndrimit në plazhë sikurse edhe viteve tjera edhe këtë vitë kemi pasur krofne gratis nga z.Ali



Kraja I cili kishte siguruar edhe 50 krofne për udhëtim

**Rekreacionet** – Janë organizuar shetitja ku fëmijët janë shërbyer me akullore ajo e Lluna Parkut, shoppingu me nënat ku krahas tyre ka qenë edhe shëtitja te Kalaja e Ulqinit si dhe dalja e disa fëmijve çdo mëngjes te Pishat ku është vendi I përshtatshëm për përmirësimin e frymëmarrjes (organet e frymëmarrjes)



**Aktivitetet e mbrëmjes** – Gjatë mbrëmjeve janë mbajtur aktivitete të ndryshme si ajo e hapjes solemne, nata ku fëmijët kanë recituar, kënduar dhe vallëzuar e që për disa fëmijë ishte hera e pare që dilte para publikut.

**Show** I përgatitur nga nënat ku si musafir kishim edhe kryetarin e Handikosit z.Halit Ferizi

**Festimi** I ditlindjes se fëmiut(Lorandit Aliut) këtu vlen të përmendet se pronari I marketit “Mango” ka dhuruar

gjëra ushqimore ne vlerë për afërsisht 15€ mirpo nuk ka qenë vetëm kjo pasi që nga ky market fëmijve u janë dhuruar edhe herave tjera gjëra ushqimore e sidomos ditën e fundit prap u janë dhuruar gjëra ushqimore për udhëtim.

**Pjesa** teatrale me q’rast nga nënat është përgatitur imitimi I puntoreve të Handikos-it pjesmarrëse në kamp.

**Kuizi** me nënat ku si juri kemi patur musafirët nga grupi I dytë dhe ai treti ndërsa nënat janë ndarë në dy grupe ndihmëse me nga tri përfasuese.

**Party-** fëmijët me maska, si dhe është bërë hapja e ekspozitës me q’rastë ka pasur edhe vallzim, këndim e recitim nga fëmijët e po ashtu edhe nga prindërit.



**Ngritja e Njohurive** – Gjatë qëndrimit në kamp janë mbajtur katër takime të ndara me prindërit e fëmijve në bazë të diagnozave e që pjesa mjeksore është ligjëruar nga dr.Vera Pitaqi,janë mbajtur 2 takime për Paralizen Cerebrale, 1 takim për dg.Sy.Down si dhe 1 takim për Spina Bifidën si dhe dg.të ndryshme.Takimet ishin interactive ku u njoftuan mbi etiologjinë, shkaktarët, pasqyren klinike, qregullimet dhe komplikimet tjera që mund



ti shoqrojnë prandaj qëllimi I këtyre takimeve ishte:

Prezentimi i pasojave nga patologjitë e diagnozave.

Dhënja e këshillave mbi parandalimin e aftësis së kufizuar.

Dhënja e këshillave për rehabilitimin e mëtutjeshëm në shtëpi.

Senzibilizimin e prindërve mbi qështjen e shkollimit të fëmijve etj.

**Kujdesi Mjekësor** – Çdo mëngjes (para ngrënies së mëngjesit) fëmijve u është dhënë vitamin C, ndërsa numri I atyre që kanë kërkuar ndihmë mjeksore gjatë këtyre 10 ditve është paraqitur në tabelën në vijim sipas datave:

<u>Data</u>	<u>26</u>	<u>27</u>	<u>28</u>	<u>29</u>	<u>30</u>	<u>31</u>	<u>01</u>	<u>02</u>	<u>03</u>	<u>04</u>	<u>05</u>
fëmijë	02	03	02	01		01		02			
prindër				01		01		02	03	03	02

Problemet më të shpeshta mjeksore kanë qenë: temperatura, barkqitje, dhimbje (dhëmbi, barku, koke etj), problemet me tension te prindërit

### **Rezultatet-**

**-Fëmiu Gentrit Smakolli** I cili ka qëndruar vetëm I mbyllur sa ka qenë në shtëpi, është adoptuar shumë mirë katër ditët e fundit të kampit

**-Të gjithë fëmijët** janë futur në ujë, ku shumica prej tyre këtë nuk e kishin provuar më pare.

**-Fëmiu Emir Hyseni** ka filluar ta përdor karrocën me dy duart, pas shumë këshillave sepse deri atëherë voziste karrocën her me njëren apo tjetren dorë.

**Të tjera** – Shetitja me anije është bërë gratis nga I njejt person sikurse edhe vitin e kaluar po ashtu edhe qadrat kanë qenë gratis sikurse edhe vitin e kaluar Furra e bukës Evropa ka dhuruar 125 kiflet të llojeve të ndryshme për udhëtim e kjo është bërë falë bashkpunimit pronarit të hotelit me këtë furrë po ashtu persona të ndryshëm gjatë qëndrimit në plazhë kanë dhuruar gjëra të ndryshme ushqimore me vetë dëshirë për fëmijët prandaj falemndrit për të gjithë ata që kontribuan në mënyra të ndryshme gjatë këtij kampi e përshëndetje e veqant shkon për fëmijët të cilët pa hezitim dhe me vet dëshirë ju bashkangjiteshin aktiviteteve tona në plazhë si dhe shoqimin e tyre me fëmijët pjesmarrës të kampit.



**Përshtypjet e kampit** – Nga fëmijët: Falemnderit juve për të gjitha që bëtë për ne e veqmas për buzqeshjet në fytyrat tona.

- Përshëndetjet më të ngrohta dhe falenderimet më të sinqerta për OJQ “R.BAZZONI”

Nga prindërit:

- Ky kamp ishte befasia më e këndshme në jetën tonë, përfituam shumë falë juve “R.BAZZONI” e juve zoti ju shpërbleftë, zoti I bekoftë shpirtërat e atyre që u sakrifikuuan për ti ndihmuar fëmijët tanë.

- Ka qenë hera e pare që fëmijët tanë të derdhin lotë gëzimi duke I shijuar këto 10 ditë dhe ne si prindër duke I shikuar aftësit e fëmijve tanë që më parë nuk I kishin treguar e që na bënë ti harojmë paaftësit e tyre e gjithë kjo falë juve “R.BAZZONI”.

- Falemnderit “R.BAZZONI” që na mundësuar që fëmijët tanë për herë të pare ta shijojnë këtë knaqësi pasi që disa prej tyre nuk kanë pasur mundësi as prej shtëpive të dalin.

- Falemnderit “R.BAZZONI” këto ditë kurr nuk do ti harrojmë.

**Vërejte:**

Një fëmij nga Vushtrria është kthyer prapa gjatë rrugëtimit për në Prishtinë, për shkaqe familjare.

Fëmiju Denis Azemi është kthyer nga Ulqini në ditën e gjashtë të qëndrimit për shkaqe familjare.

Vera Pitaqi  
Hatixhe Salihu  
Lumnije Muzaqi  
Shukrie Vokshi

Prishtinë: 21/09/06